MBËSHTETJA TEKINIKE NË SHKOLLË

Në këtë kapitull do të gjeni:

- Çfarë nënkupotjnë funksionet proakitive në skuadrën mbështetëse teknike të shkollës tuaj ?
- Cilat janë llojet e ndyshme të sfidave që ju mund t'i hasni derisa jeni duke përdorur Kompjuterin tuaj personal?
- Me cilat sfida përballet përdoruesi?
- Cilat janë sfidat potenciale për rrjetin?
- Si mund t'i zgjidhni sfidat harduerike?
- Si mund t'i zgjidhni sfidat e thjeshta të prezantuara nga Windows që janë të ndërlidhura me lidhjen e kompjuterit apo konfirgurimit të tij?

Në fund të këtij kapitulli do të jenë në gjendje të:

1] Konstatoni se do t'u duhet trajnimi, për të qenë në gjendje të ofroni mbështetje për Kompjuterët personal të shkollës tuaj.

2] Identifikoni lloje të ndryshme të vështirësive të papritura në Kompjuterët personal.

3] Identifikoni sfidat të ndërlidhura me përdoruesit, rrjetin, harduerin dhe sistemin operativ.

4] Gjeni mënyra për të zgjidhur sfidat potenciale në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë.

HYRJE NË KAPITULL

Konsolidimi i skuadrës teknike mbështetëse në shkollë është një hap esencial në këtë udhëtim. Në kapitullin e mëparshëm ua prezantuam të gjitha aspektet e sistemit të ri operativ.

Ju e kuptuat mënyrën se si punon sistemi operativ në kuadër të Kompjuterëve personal dhe mësuat si ta instaloni atë, ta konfiguroni dhe të shfrytëzoni të gjitha përparësitë e veçorive të tij bazuar në nevojat tuaja dhe të shkollës tuaj.

Tash është koha të jeni në gjendje t'i ofroni shkollës mbështetje teknike pro-aktive, e kjo do të thotë të gjeni defektet potenciale, të jeni në gjendje t'i riparoni apo mënjanoni ato dhe çdo vështirësi tjetër dhe të zgjidhni çdo problem eventual që do të paraqitet.

Në këtë kapitull ne do t'ua prezantojmë sfidat/çështjet kryesore me të cilat do të përballeni dhe sigurisht që do të keni nevojë për ndihmë nga stafi i shkollës, ashtu që të mund të organizoni, së bashku me shokët tuaj të klasës, dhe të planifikoni masa preventive për mirëmbajtje.

Më vonë në kapitujt vijues temën e trajtuar këtu do ta gjeni të shtjelluar edhe më detajisht. Për shembull në kapitullin e gjashtë do të jeni në gjendje të mësoni se si do të bëhet mirëmbajtja specifike e SO Windows 7. Në kapitullin e shtatë do të zgjeroni njohuritë tuaja rreth rrjeteve. Siç edhe mund të shihni kemi një rrugë të gjatë për të bërë! Pra të vazhdojmë me këtë kapitull dhe të fillojmë organizimin e skuadrës teknike mbështetëse të shkollës suaj.

HARTA KONCEPTUALE E KAPITULLIT



DETYRAT E SKUADRËS TEKNIKE MBËSHTETËSE

Kur ta përdorni një sistem operativ mund të paraqiten disa vështirësi dhe ju, si anëtar i skuadrës teknike mbështetëse, do të duhet të jeni në gjendje t'i mënjanoni ato. Kështu, në të shumtën e rasteve do të jeni në gjendje t'i zgjidhni ato,

A e keni ditur se…?

…se më tepër se 80% e sfidave meKompjuterëve pesonal vijnë si rezultat i mungesës së mirëmbajtjes?

thjesht duke realizuar konfigurimet e duhura.
Pra, për të qenë në gjendje t'i zgjidhni ato, do t'ua prezantojmë çështjet më të shpeshta që ju do të hasni, kur ta përdorni Kompjuterin personal për punët tuaja të përditshme.

Llojet e sfidave

Në njërën anë do të gjeni vështirësitë e përdoruesve. Kjo do të ndodhë kur detyrat janë të ekzekutuara në mënyrë të gabuar, apo është bërë ndonjë gabim në përzgjedhjen e veçorive. Kjo situatë mund të ngjajë kur Kompjuteri personal nuk përgjigjet, nuk mund të gjeni një aplikacion, program apo skedarë që keni qenë duke e përdorur apo kur përgjigja për një veçori që e keni përzgjedhur nuk është ajo e pritura.

Në anën tjetër do të përballeni me sfidat harduerike siç janë: probleme me kabllo, apo pajisje të dëmtuara apo të lidhura gabimisht, që përgjithësisht mund të pengojnë hyrjen dhe daljen e informatave. Këto defekte paraqiten në të shumtën e rasteve si pasojë e mos përditësimit të drajverëve, por më vonë do të shihni se këto procese janë edhe më të lehta në Windows 7.

Ju do të përballeni edhe me sfida të sistemit operativ, të cilat do të diskutohen përgjatë tërë kapitullit dhe ato janë të ndërlidhura me:

- Mbrojtja e informatave të ruajtura,
- Mbrojtja e sistemit ndaj çdo lloj të softuerëve të dëmshëm,
- Përdorimi i Activity Center si mënyrë për të kërkuar zgjidhje për problemet potenciale .

Finally, we'll introduce the **Network Issues**, such as installing a printer, configuring Internet options, enabling a firewall or establishing security levels. You will be able to get deeper into these aspects in the following pages.

USER ISSUES

Le të fillojmë me disa masa të ndërlidhura me përdoruesit, ashtu që të lehtësojnë detyrat tuaja si anëtar i skuadrës mbështetëse teknike.

Krijimi i llogarive të përdoruesve

Ne preferojmë shumë të krijoni lloje të ndryshme të përdoruesve në kuadër të një Kompjuteri personal. Gjithashtu rekomandojmë të krijoni llogari të ndryshme për të diferencuar përdoruesit, të cilët nuk kanë të drejta si administrator, nga të tjerët që kanë qasje në këto opsione.

Si administrator, përdoruesi do të ketë qasje në operacione të caktuara, të cilat nuk do të ishte në gjendje t'i ekzekutonte po të mos kishte të drejtat e tilla siç janë: deakitvizimi i firewallit, instalimi apo deinstalimi i një aplikacioni.

Përdoruesi

Zakonisht i quajmë "përdorues" çdo person që i përdorë resurset kompjuterike, pavarësisht se a janë ato programe apo pajisje harduerike. Por, për nga aspekti i llogarive të përdoruesve, e përdorim këtë fjalë për t'iu referuar një identiteti, me të cilin bashkërendojmë me Kompjuterin personal. Ky identitet ka leje, të drejta dhe karakteristika për të pasur qasje në vende të ndryshme dhe të ekzekutojë aplikacione të caktuara, në bazë të asaj se çfarë është specifikuar.

Në kapitulln e tetë do të gjeni më tepër informata rreth sjelljeve dhe kontrollit të përdoruesve, kurse tani mund të lexoni disa pyetje të shpeshta të parashtruara në Internet.

http://windows.microsoft.com/es-XL/windows7/User-accounts-frequently-asked-questions

Administratori

Për dallim nga llogaria e përdoruesve, administratori mund të bëjë ndërrime në Kompjuterin personal dhe këto ndërrime do të afektojnë edhe përdoruesit tjerë.

Për dallim nga llogaria e përdoruesve, administratori mund të bëjë ndërrime në Kompjuterin personal dhe këto ndërrime do të afektojnë edhe përdoruesit tjerë. Kështu, duke kufizuar të drejtat vetëm për administratorin do të ndihmoni mënjanimin e viruseve dhe spyware (softuer për spiunim) sepse programet e dëmshme mund të shfrytëzojnë të drejtat e dhënat për të realizuar operacione të dëmshme në Kompjuterin tuaj personal.

Windows 7

Kontrollimi i llogarive të përdoruesve është një veçori e re, e cila mbron sistemin operativ. Ne rekomandojmë që ai në Kompjuterin tuaj të jetë gjithmonë i aktivizuar. Për të verifikuar statutin e tij duhet të shtypni "control of user accounts" në Start menynë e Windows 7. Kur të futeni aty, verifikoni se a është i aktivizuar ky funksion.

Mënyra e shpejtë!

Për të ekzekutuar veprime si administrator në SO Windows 7, duhet të klikoni me tastin e djathtë në mënyrën e shpejtë (shortcut) të aplikacionit që dëshironi ta përdorni. Kështu do të prezantohet Menyja kontekstuale dhe ju do të duhet të përzgjidhni opsionin Execute as Administrator (ekzekutoni si administrator).

Kështu, ju do të jeni "gjithmonë të gatshëm" për të ndihmuar shokët tuaj shpejt dhe lehtë.



SFIDAT HARDUERIKE

Njëra nga veçoritë kryesore të Windows 7 është aftësia për të zgjidhur sfidat në mënyrë të lehtë, madje edhe kur konfigurojmë pajisjet, që kanë punuar në sistemin e mëparshëm operativ, për të cilët duhet t'i instaloni drajverët përkatës të pajsijeve periferike, që ju do të dëshironi t'i lidhni.

Konfigurimi i pajisjeve të reja

Në Windows 7 është shumë më lehtë të instalohet dhe të konfigurohen pajisjet me portë lidhëse USB.

Thjesht ju duhet të lidhni pajisen dhe Windowsi do ta instalojë atë. Nëse pajisjes I duhet drajver (softuer) i veçantë, sistemi do të lidhet në Internet dhe do të shkarkojë atë shpejt dhe lehtë dhe do të na informojë kur ajo të jetë instaluar e që është e gatshme për t'u përdorur.

Një temë e rëndësishme, të cilës duhet t'i kushtoni rëndësi është ta mbani SO të përditësuar. Prodhuesit e softuerëve publikojnë përditësime ashtu që prodhimet e tyre të posedojnë veçori të reja dhe të jenë të gatshme të ballafaqohen me rreziqet e sigurisë.

Windows 7 posedon një komponentë të ashtu quajtur Windows Update, e cila I mundëson sistemit operativ, por edhe shumë aplikacioneve që të jenë vazhdimisht të përditësuara.



Ne rekomandojmë që ta aktivizoni Windows Update, ashtu që do ta mbani atë të përditësuar.

Për ta realizuar këtë ju duhet të shtypni: Windows Update në Start meny dhe pasi të keni hyrë në pjesën e majtë do të shihni Change settings option. Pasi të jeni future aty mund të zgjidhni opsione të ndryshme.

Përpos kësaj, sa i përket akordimeve harduerike, duhet të dini se mund të zgjidhni edhe çështje të ndërlidhura me stilet vizuale apo akordime të zërit nga çdo përdorues, duke shtypur **transparencies** apo **sound issues në shfletuesin Start.**





Mbani mend…

Nëse e deaktivizoni përditësimin automatik, duhet ta realizoni atë në mënyrë periodike dhe manualisht.

A keni probleme me zërin a është i ndryshueshëm dhe me pengesa?

Nëse zëri i kompjuterit tuaj është i ndryshueshëm apo me pengesa duhet të verifikoni se a janë të lidhur altoparlantët në mënyrë të duhur. Zakonisht këto probleme shfaqen kur kabllot e altoparlantëve nuk janë të lidhura në portat e duhura. Pra, duhet ta verifikoni se a janë ata të lidhur në portën line out. Nëse nuk mund të dalloni këtë portë nga të tjerat, mundohuni t'i lidhni ata në porta tjera të kartelës së zërit derisa të mund të dëgjoni zë të mirë nga Kompjuteri juaj personal.

Pastrimi dhe mbrojtja e Harduerit

Në shumë raste ne mund ta zhvlerësojmë faktin se Kompjuterët personal kanë nevojë të pastrohen dhe të mbahen në gjendje të mirë fizike, por kjo konsiderohet një masë po aq e rëndësishme sa edhe ato të përmendura më parë.
Metoda më e mirë për ta pastruar kompjuterin është shfrytëzimi i sprejit pa CFC (përmbajtje të rrezikshme kimike për ambientin), sepse ky lloj mundëson largimin e pluhurit në mënyrë të lehtë dhe duke mos e dëmtuar ambientin dhe kështu do të mirëmbani Kompjuterin personal pa e dëmtuar mbrojtësin e Ozonit.
Ne gjithashtu rekomandojmë që ta mbroni Kompjuterin tuaj personal ndaj lëkundjeve të tensionit në pjesën furnizuese të kompjuterit. Shumë shpesh hasim edhe në ndërprerje të papritura apo nivel të ultë/të lartë të tensionit dhe të gjitha këto mund ta dëmtojnë Kompjuterin tuaj. Këto dëmtime mund të jenë të llojllojshme siç janë: djegia e elementeve, dëmtimi i sistemit operativ etj. Një mënyrë për të mbrojtur ato është shfrytëzimi i stabilizatorëve të tensionit, të cilët do të balancojnë furnizimin me tension, që futet në Kompjuterin tuaj personal, por ata nuk janë masë preventive ndaj ndërprerjes së furnizimit.
Përfundimisht, duhet të mbani komponentët harduerik të përditësuara, ashtu që operacionet e disa aplikacioneve dhe softuerëve të Kompjuterëve personal do të mund të optimalizohen.

Udhëzim!

Për të mbajtur Kompjuterët tuaj personal të pastër mund të krijoni, së bashku me shokët tuaj të klasës, postera paralajmërues se si të shfrytëzohen Kompjuterët personal. Kështu, mund të ndërmerrni masa preventive për sfidat që mund të paraqiten siç janë: derdhja e lëngjeve në tastaturë, dëmtimimi i miut përmes thërrmijave të ëmbëlsirave me alkool etj.

Gjeni mënyra kreative për t'iu treguar shokëve të klasës se edhe ata duhet të kenë kujdes ndaj Kompjuterëve personal të shkollës!

Një arsye për të rishikuar temën!

Radhitni hapat sipas sekuencës, me qëllim që të kërkoni informatat në lidhje me veçoritë e Kompjuterit tuaj personal dhe pastaj verifikoni statusin e Kompjuterëve të shkollës tuaj sa i përket RAM memories dhe procesorit. Cilat komponente mendoni se duhet t’i përditësoni?











SFIDAT E SISTEMEVE OPERATIVE

Në këtë kapitull sigurisht që keni kuptuar se sa e rëndësishme dhe efektive është Start menyja e SO Windows 7, si një vegël për përdorimin dhe ekzekutimin e sistemit operativ. Por ju mund të dëshironi më tepër rezultate dhe të jeni në gjendje ta realizoni operacionin "Repair index" (Indeksi i riparimit)

Indeksimi

Për ta realizuar këtë detyrë, në në Start meny duhet të shkruani Indexing, pastaj klikoni në Advanced Options (Opcionet e avancuara) klikoni në Reconstruct (rekonstruktoni) në kuadër të Troubleshooting (zgjdhja e problemeve). Merrni parasysh se koha për këtë proces do të varet nga sasia e Informatave që keni në Kompjuterin tuaj personal.
Ju gjithashtu duhet ta aplikoni një vegël të rëndësishme për zgjidhur vështirësitë me sistemin operativ. Kur skuadra të hasë në ndonjë vështirësi, Windows 7 posedon një vegël rigjeneruese e ashtuquajtur "Restore system" (sistemi regjenerues), e cila lejon që sistemi të kthehet në statusin e mëparshëm, kur edhe defektet nuk kanë ekzistuar.

Çka është regjimi i sigurt i punës?

Kur duhet të zgjidhni sfidat e shkaktuara nga ndonjë aplikacion apo drajver, duhet ta ristartoni Kompjuteri tuaj personal në regjimin e sigurt të punës (Safe mode). Në atë rast Windows do të startojë me numër të kufizuar të skedarëve dhe drajverëve, si dhe programet startuese nuk do të ekzekutohen. Në Safe Mode, do të jeni në gjendje të riparoni defektet potenciale duke e mbyllur programin përgjegjës për ato probleme, apo duke u kthyer tek pika regjeneruese përmes veglës"Restore system" (Sistemi rigjeneruues).

Për të vepruar ashtu, duhet ta startoni Windowsin në Safe Mode duke shtypur disa herë F8 derisa jeni duke e startuar Kompjuterin personal.
Në rast se Windows do të gjejë ndonjë gabim ai do të startojë automatikisht në Safe Mode.



Ekzekutimi i aplikacioneve që nuk janë kompatibile me sistemin operativ

Nganjëherë ju mund të gjeni aplikacione, të cilat nuk janë kompatibile me Windows 7. Megjithatë, SO Windows 7 thjeshtëson gjithçka në kuptimin që procesi është pothuajse transparent për ju, gjegjësisht për përdoruesin e fundit.
Pasi që të jetë paraqitur një lajmërim se keni gabime dhe ju njofton për situatën, sistemi do t'iu pyes se a doni të ekzekutoni aplikacionin me opsionet e rekomanduara.
Nëse klikoni në Yes, Windows 7 do të provojë të instalojë aplikacionet në Compatibility mode (regjimin kompatibil), dhe do të provojë një mënyrë tjetër për ta instaluar atë dhe ta fusë atë në punë.
Nëse dëshironi të aktivizoni këtë opsion në mënyrë manuale ju duhet të klikoni me tastin e djathtë në ikonën e hapit të shkurtë (shortcut) dhe përzgjidhni opsionin Properties.
Nëse jeni në atë dritare duhet të klikoni në shenjën Compatibility.

Në atë rast do të jeni në gjendje të përzgjidhni të përdorni aplikacione duke shfytëzuar Regjimin kompatibil të punës, që është i bazuar në versionet e mëparshme të SO Windowsit.



Nëse jeni duke i realizuar këto ndërrime në konfigurime, që ndërlidhen me regjimin kompatibil të punës dhe nuk mund të ekzekutoni aplikacionet, vizitoni faqen e Internetit të prodhuesit të atij programi, për të verifikuar se a ka ndonjë përditësim të atij aplikacioni.

SFIDAT E RRJETIT

Një temë e rëndësishme, kur jemi duke mbështetur Windows 7, është edhe lidhja në rrjet.
Nganjëherë, ju dëshironi të lidheni në një rrjet dhe dështoni ta bëni këtë, apo të humbni lidhjen pasi që ajo të jetë realizuar.
Në atë moment Windows 7 do t'iu ndihmojë ta zgjidhni atë.
Ju duhet ta shtypni "Network issue"(Çështjet e rrjetit) në Start smart menynë e Windows 7 dhe pastaj do të paraqitet "Find and troubleshoot connection and network issues" (Gjeni dhe riparoni sfidat me lidhjet dhe ato të rrjetit).
Duhet të klikoni në Next dhe Windows 7 do të ofrojë disa opsione për ju, për të zgjidhur çfarëdo lloj sfide me lidhjen në rrjet.

Mësoni më tepër për këtë temë në kapitullin e Rrjeteve!

Zbuloni se kush merret me secilin problem në këtë skuadër të mbështetjes teknike...

Anëtarët e ekipot janë:

MARTÍN
JESSENIA
LEO
ALMA

Llojet e sfidave të regulluara nga secili prej tyre janë:

Sfidat e PËRDORUESVE
Sfidat e HARDUERIT
Sfidat e SISTEMIT OPERATIV
Sfidat e RRJETIT

Veçoritë e dhëna janë…

01 Asnjëra nga femrat nuk di shumë për komponentet fizike të Kompjuterëve personal.
02 Djemt Martini dhe Leo janë 21 gjegjësisht 17 vjeçar.
03 Anëtari më i ri i do rrjetet dhe pyet se a mund të merret me këto çështje në kuadër të skuadrës së mbështetjes teknike.
04 Njëra nga femrat është një mësuese 26 vjeçare.
05 Jessenia nuk e ka konfiguruar llogaritë e përdoruesit të kabineteve me Kompjuter personal.
06 Personat më të vjetër se 20 vjet nuk merren me çështje të rrjetit.
07 Alma është nxënëse dhe është dy vite më e re se Leo.
08 Martini ende nuk e ka mësuar se sit të kufizojë lejet për llogari.

	AGE	KIND OF ISSUE			
		USER	HARDWARE	OPERATING SYSTEM	NETWORK
MARTÍN	21				
JESSENIA			X		
LEO					
ALMA					

Me rëndësi!

Gjithmonë mbani në mend se Windows 7 Activity Center do të jetë vendi ku do të jeni në gjendje ta verifikoni "Statusin shëndetësor të Kompjuterit tuaj personal". Ju duhet të shkruani Activity Center në Windows 7 Start meny dhe aty do të gjeni të gjitha informatat që ju duhen.



Udhëzimi i gjelbër!

Njëra nga strategjitë momentale për të zvogëluar efektet e ndërrimeve klimatike dhe mbrojtur mjedisin është të marrim masa për kursimin e energjisë.
Përkundër se kjo është një sfidë e përmasave globale, neve na duhet të dimë se mund të arrijmë këtë qëllim duke ndërruar sjelljet tona të përditshme. Pra, nëse ne thjeshtë e ndalim Kompjuterin personal, në kohën kur nuk jemi duke e shfrytëzuar atë, ne do të ndihmojmë kështu në kursimin e energjisë.
Si anëtar i skuadrës për mbështetje teknike të shkollës mund ta shndërroheni në një shembull për nxënësit dhe mësimdhënësit nëse e ruani mjedisin natyror. Për të arritur këtë këtu do t'i gjeni disa strategji, të cilat do të mund t'i ofroni komunitetit të arsimit, ashtu që edhe ata t'i bashkohen në përpjekjet për mbrojtjen e ambientit.
- Inkurajoni shokët tuaj të klasës t'i fikin Kompjuterët personal, kur ta përfundojnë punën e tyre, apo në rast se ata kompjuter nuk do të shfrytëzohen për një periudhë më të gjatë kohore.
- Udhëzoni mësimdhënësve që ta evitojnë ndezjen e të gjithë Kompjuterëve personal të kabinetit të Informatikës, nëse ai nuk do të jetë i mbushur gjatë orës mësimore.
- Inkurajoni njerëzit të ndalin monitorët nëse Kompjuterët personal nuk do të shfrytëzohen për një kohë më të gjatë.

Mund të krijoni postera paralajmërues me këto udhëzime, së bashku me udhëzimet se si të kujdeseni për Kompjuterët personal. Ofroni shokëve tuaj të klasës "udhëzime të gjelbërta" dhe befasoni ata!

Të qeshim në vete!

Kryeni detyrat vijuese dhe filloni të krijoni skuadrën mbështetëse teknike të shkollës tuaj

A. Me cilat detyra do të përballet skuadra teknike? Krijoni listën e detyrave, që ju mendoni se janë esenciale për të inkurajuar funksionalizim të mirë të Kompjuterëve personal të shkollës suaj. _____

_____

_____

_____

B. Përmes intervistave realizoni një hulumtim për të identifikuar se me cilat sfida përballen zakonisht përdoruesit e Kompjuterëve personal të shkollës suaj. Kur t'i keni të gjitha informatat, klasifikoni ato sipas kategorive që keni mësuar në këtë kapitull.

C.Organizoni skuadrën për mbështetje teknike në shkollë. Shkruani emrat e atyre që do të merren me zgjidhjen e sfidave të ndryshme rreth Kompjuterëve personal.

ISSUE/ERROR	USER ISSUES

D. Rishikoni temën kryesore të mbështetjes teknike dhe kthehuni tek Indeksi për të gjetur se cilët kapituj përshkruajnë detajisht sfidat e ndryshme.

USER ISSUES	HARDWARE ISSUES	OPERATING SYSTEM ISSUES	NETWORK ISSUES

Për shembull: "Sfidat rreth rrjetit" në kaptiullin e 7".

_____

_____

Vetë vlerësimi

Përgjigjuni në pytësorin vijues dhe verifikoni se sa keni mësuar në këtë kapitull.

1. Çfarë nënkupton mbështetja proaktive teknike?

a. Marrja e veprimeve kur sfidat të jenë paraqitur
b. Marrja e veprimeve para se të shfaqet sfida
c. Është e realizuar në mënyrë manuale

2. Nëse përballemi me një sfidë rreth kabllove të Kompjuterëve personal kjo është….

a. Sfidë e përdoruesit
b. Sfidë harduerike
c. Sfidë softuerike

3. Çfarë lloji i sfidave është ruajtja e informatave të Kompjuterit personal?

a. Sfidë e Sistemit operativ
b. Sfidë e përdoruesit
c. Sfidë e rrjetit

4. Si e quajmë përdoruesin që posedon të gjitha të drejtat për të përdorur Kompjuterin personal?

a. Përdorues unik
b. Administrator
c. Support user Përdorues mbështetës

5. Si e quajmë komponentën e SO Windows 7 që e mban Kompjuterin personal të përditësuar?

a. Windows Update
b. Windows Installer
c. Ongoing update (përditësimi vazhdueshëm)

6. Çfarë elementesh mund të shfrytëzojmë për të mbrojtur Kompjuterët personal nga lëkundjet e tensionit?

a. Routerët
b. Stabilizatorët e tensionit
c. Hub

7. Kur të ballafaqoheni me defekte në lidhjen tuaj të Internetit, çfarë duhet të shkruani në menynë Start për ta rregullur atë?

a. Connection issues (Qështje e lidhjes)
b. Internet issues (Qështje e Internetit)
c. Network issues (Qështje e rrjetit)

8. Pluhuri dhe papastërtitë mund të ndikojnë tek performansa e mirë e komponenteve

a. True (e saktë)
b. False (e pasaktë)
c. Indistinct (e pacaktuar)

9. Çfarë do të ndodhë nëse një aplikacion nuk është kompatibil me Windows 7?

a. Nuk mund ta instalojë atë në Kompjuterin tim personal
b. Windows 7 do të më ndihmojë për të gjetur regjimin kompatibil duke ekzekutuar atë me opsionet e rekomanduara
c. Asnjëra prej opsioneve nuk është e saktë

10. Në cilin regjim të punës më duhet ta startojë Windows 7 nëse dua të kthehem në pikën regjeneruese për shkak të problemeve potenciale?

a. Safe mode (Regjimin e sigurt)
b. Normal mode (Regjimin normal)
c. Safe boot mode (Regjimin e sigurt të ngritjes së SO